



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2018:017219
Datë: 23.12.2021
Numri i dokumentit: 02545096

PA1.nr.1004/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm - në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Hashim Çollaku - kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Zyhdi Haziri - anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, në çështjen penale kundër të akuzuarve D. B. nga P.... dhe G. B. nga P....., për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë në tentativë, nga neni 327 par. 1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), për të vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.865/20, datë 05.05.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur konform të dispozitës së nenit 390 të KPP-së, me datë 28.10.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.865/20, datë 05.05.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren, me aktgjykimin P.nr.865/20, datë 05.05.2021, të akuzuarit D. B. dhe G. B. i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë në tentativë, nga neni 327 par. 1 lidhur me nenin 28 dhe 31, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), ashtu që të akuzuarit D. B. për shkak të kësaj vepre penale i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve dhe dënim me gjobë në lartësi prej 500 (pesëqind) euro, të cilën shumë është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim i njëjti do të zëvendësohet me 25 (njëzet e pesë) ditë dënim burgu duke llogaritur për 20

euro një ditë burgu. Ndërsa të akuzuarin G. B. për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve dhe dënimin me gjobë ë lartësi prej 500 (pesëqind) euro, zë cilën shumë është i obliguar të paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim i njëjti do të zëvendësohet me 25 (njëzet e pesë) ditë dënim burgu duke llogaritur për 20 euro një ditë burg. E dëmtuara L. B. , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil. Janë obliguar të akuzuarit që të paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së kësaj gjykate, në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën nga 20 € secili veç e veç, si dhe shumën me nga 30 euro secili veç e veç, në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit, e të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar :

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vendimit mbi dënimin, duke propozuar që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovojë si të bazuar këtë ankesë dhe të ndryshoj vendimin gjykatës së shkallës së parë, ashtu që të akuzuarve D. B. dhe G. B. t'iu caktojë dënime më të larta të cilët do të jenë në proporcion me peshën dhe natyrën e veprës penale dhe me të cilët do të arrihet qëllimi i dënimit sipas ligjit penal.

Prokurori i Apelit në Prishtinë me parashtresën PPA/II.nr.1020/2021, datë 03.08.2021, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe ndaj të akuzuarve të iu shqiptoj dënime më të larta.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, caktoj dhe mbajti seancën e kolegjit, konform të dispozitës së nenit 390 të KPP-së e për të cilën seancë ftoj në mënyrë të rregullt Prokurorin e Apelit, të akuzuarit dhe të dëmtuarën. Në seancë prezantuan të akuzuarit. I akuzuari D. B. propozon që të refuzohet si e pabazuar ankesa e prokurorit dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet. I akuzuari G. B. propozon që të refuzohet si e pabazuar ankesa e prokurorit dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet. Në seancë nuk prezantuan Prokurori i Apelit dhe e dëmtuara L. B. edhe pse të ftuar në mënyrë të rregullt.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të nenit 394 të KPP, dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Aktgjykimi i shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, me pretendime që dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin e tij respektivisht arsyetimin mbi dënimin. Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarve, e të cilat do kishin kushtëzuar anulimin e tij.

Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilave u referohet në ankesë prokurori , ngase dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, në të nuk ka kundërthënie me vetveten e as me arsyet e tij, është i qartë dhe konkret. Aktgjykimi i kundërshtuar përmban arsyet e duhura mbi të gjitha faktet relevante të kësaj çështje penale. Kjo Gjykatë vlerëson se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje tjera esenciale e të cilat kjo Gjykatë sipas dispozitës së nenit 394 të KPP-së i shqyrton çdo herë detyrimisht.

Prokurori e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të vendimit mbi dënimin, duke pretenduar që dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve janë tejet të buta, nuk janë në proporcion me peshën e veprës penale dhe rrethanat në të cilën është kryer vepra penale si dhe ekzistimin e rrethanës rënduese ndaj të akuzuarit se të njëjtit janë recidivistë. Gjykata në rastin konkret ka mbi vlerësuar rrethanat lehtësuese duke iu dhënë rendësi më të madhe se sa që meritojnë. Gjykata në rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, ndaj të akuzuarve është dashtë të marrë për bazë dhe të vlerësoj drejtë edhe rrethanat rënduese dhe atë rrezikshmërinë shoqërore si dhe faktin se veprat penale të kësaj natyre janë të shprehura mjaftë dhe janë në rritje e sipër. Me dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve nuk do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë me dispozitat përkatëse ligjore, andaj edhe propozon që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarve të iu shqiptohet dënim më i ashpër.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore të prokurorit, që të akuzuarve të iu shqiptohen dënime më të ashpra, nuk janë të bazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila do ta arsyetonte shqiptimin e dënimeve më të ashpra, ndaj të akuzuarve. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 73 të KPK-së. Kështu gjykata si rrethana lehtësuese për të akuzuarit D. B. mori faktin se i njëjti është penduar për veprimet e ndërmarra, ka kërkuar falje para gjykatës, sjellja korrekte e të akuzuarit gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi i tij për kryerjen e veprës penale, premtimin se në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e këtilla kundërligjore, është i papunë, ndërsa për të akuzuarin G. B. , si rrethana lehtësuese gjykata mori parasysh, sjelljet korrekte të akuzuarit, është mbajtës i familjes dhe në prezencë të këtyre rrethanave të akuzuarve i shqiptoj dënime si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e të prokurorit për rrethana rënduese nuk janë të atij karakteri dhe nuk kanë ndikim që të akuzuarve të iu shqiptohen dënime më të ashpra. Të gjitha këto rrethana, sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuara nga ana

e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve janë në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.1004/21, më datë 28.10.2021

Zyrtarja ligjore,
Rrezarta Bala

Anëtarët e kolegjit:
Ferit Osmani

Kryetar i kolegjit,
Hashim Çollaku

Zyhdi Haziri